



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 684/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtuar nga Feim Ademaj, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Feim Ademaj, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, për vendvotimin 1726C/02R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve të kutisë së votimit për Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Feim Ademaj, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë në të cilën pretendon se në 1726C/02R i janë ndryshuar dhe në vend që ti përshkruhen 24 votat kandidatit me nr 8 votat të njëjta i janë përshkruar një kandidati tjetër me nr. 9.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 1726C/02R, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, nuk ka asnjë votë në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i apelit i posedon 24 vota të vlefshme.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

A nr. 684/2017 më datën 11.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.